



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2174/ 2 prot.,

Datë 06.09.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76170-07-27-2023, me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 6,545,796.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujesjellës Kanalizime Shkodër

**Ankimues:** “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr. 8240, Njësia Nr.6, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Ujesjellës Kanalizime Shkodër me adresë: Lagjia 3 Heronjtë, rruga Marin Biçikemi, Shkodër

Në datën 04.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3393 dhe me nr. 2174/2023 prot., datë 06.09.2023 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë objektin e pretendimeve që operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK parashtron në ankesën me numër ankimi elektronik A/2023/3393 dhe me nr. 2174/2023 prot., datë 06.09.2023.

Konkretisht objekti i pretendimeve në ankesën është si më poshtë vijon:

*“Si fillim duam t’ju tregojmë një situatë të ngjashme, me të njëjtin mall objekt prokurimi “Blerje kimikate që ka ndodhur me autoritetin kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Durrës.*

*AK, Ujësjiellës Kanalizime Durrës, më datë 03.03.2023 mbylli procedurën e prokurimit “Blerje kimikate”, dhe pasi u ndoqën të gjitha procedurat dhe afatet e ankimimit, u shpall fitues një operator ekonomik. në këtë periudhë ujesjiellës kanalizime durrës iu nënshtrua procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca te përbashkëta shoqëria rajonale ujësjiellës kanalizime durrës sh.a me niprin e ri M22031502M.*

*Mbështetur pikërisht në transferimin e të drejtave dhe detyrimeve dhe kompetencave të përbashkëta mes subjektit të vjetër UK Durrës, dhe subjektit të ri, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a, më datë 05.06.2023, me nr buletini 51 ( gjeni bashkangjitur ) autoriteti i ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a, ka njoftuar OE të shpallur fitues nga autoriteti i vjetër kontraktor, për tu paraqitur për nënshkrimin e kontratës me Shoqëria Rajonale Ujesjielles Kanalizime Durres sh.a me Niptin e ri M22031502M, kujtojmë përsëri procedure kjo e hedhur nga autoriteti UK Durrës përprasa se ti nënshtrrohej procesit procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca te përbashkëta shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a me Niprin e ri M22031502M.*

*Thënë sa më sipër ndodhemi në të njëjtën situatë në të cilën autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Shkodër do ti nënshtrrohet procesit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit me kompetenca te përbashkëta shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër me Niptin e ri M22031502M.*

*Duke qënë se autoritetit të ri kontraktor po i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, dhe kompetencat e autoritetit të vjetër, detyrimi i këtij autoritetit të ri është të lidhë dhe të vazhdojë kontratat për procedurat e hedhura nga autoriteti i vjetër . Për këtë arsye AK Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a duhet t’i referohesh edhe rastit të Ujësjiellës Kanalizime Durrës si mënyra e vetme legjitime për zgjidhjen e kësaj problematike, rast i cili është pranuar nga Agjensia e Prokurimit Publik, e cila ka aprovuar lidhjen e kësaj kontrates, në kushtet e vazhdimësisë së të drejtave dhe detyrimeve të mbartura nga autoriteti i vjetër kontraktor, duke krijuar kështu një precedent ligjor të pakontestueshem dhe të referueshëm për rastë të ngjashme. Për sa më sipër kërkojmë që ankesa jonë të pranohet dhe kontrata të lidhet me autoritetin e ri kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër, të cilit i janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e autoritetit të vjetër, Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 06.09.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Fiorent Zguro**